



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRISHTINA – BASIC COURT OF PRISTINA



DEGA NE LIPJAN-OGRAK LIPLJAN

C.nr. 232/12

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA LIPJAN, sipas gjyqtarit Avdirrahman Gashi, me sekretaren juridike Nexhmije Ahmeti, në çështjen juridiko-civile të paditësit S.J., nga fsh. D., kundër të paditurit E. H. nga P., të cilin e përfaqson D. R. av. në K., si përfaqësues i përkohshëm, përshkak të pagimit të borxhit, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të mbajtur me dt. 23.09.2016, në praninë e palëve ndërgjyqëse, muarr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e precizuar e paditësit S.J. nga fsh. D. dhe **DETYROHET** i padituri E. H. nga P. që paditësit t’ia paguajë borgjinë në emer të shitjes së palujtshmërisë në shumë prej 19.500 €, me kamatë ligjore në lartësi prej 8% nga data e nxjerrjes së aktgjykimit e deri te pagesa definitive, këto në afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit të aktgjykimit nën kërcnimin e përmbarimit të dhunshëm.

Secila pale i bart shpenzimet e veta procedurale.

II. Masa e përkohëshme e caktuar me aktvendimin e kësaj gjykate C.nr.232/2012, të dt. 03.11.2015, mbetet në fuqi deri në përfundimin e këtijë kontesti në formë të prerë.

A r s y e t i m

Paditësi fillimisht te kjo gjykatë ka parashtruar padi ndaj të paditurit E.H. nga P., për zgjidhjen e kontratës së shitëblerjes përshkak të mospërmbushjes. Në padi paditësi ka theksuar se qysh me dt. 27.01.2009, ka lidhur kontratë për shitëblerjen e paluajtshmerisë me të paditurin për ngas. kad.nr. 00352-3, në vendin e quajtur “Shiroko Pole”, në sip. prej 15165 m2, që evidentohet në Cërtifikatën e pronësisë UL-71409082-00560 ZK Suhadoll, për çmimin kontraktues prej 127.000.-€, i cili çmim është pëmbushur në pjesen më të madhe mirëpo pjesa e mbetur prej 19.500.-€, ka pasur obligim i padituri ta përmbush deri me dt. 01.03.2009. Edhe pse me parashtrësen e mëvonëshme ka kërkuar zgjerimin e padisë ku përveq të paditurit ka propozuar të përfshihen edhe të paditurit tjerë ndaj të cilëve pjesa më e madhe e paluajtshmerisë ka kaluar në emër të tyre, për këtë propozim gjykata ende pa vendosur për lejimin apo moslejimin e zgjerimit të padisë në aspektin subjektiv sa i përket të paditurve, paditësi me parashtrësen e dt. 29.08.2016, e ka ndryshuar padinë në kuptimin objektiv dhe subjektiv duke kërkuar vetëm pjesen e borxhit të mbetur të papaguar dhe ndaj të paditurit të vetëm këtu E. H. nga P..

Në shqyrtimin kryesor paditësi ka mbetur në tërësi pranë padisë dhe parashtrëses së fundit dhe ka theksuar se përkundër vërejtjeve të bëra nga paditësi, i padituri asnjëher

nuk ka shpreh gadishmeri për ta paguar këtë pjesë të mbetur të borxhit dhe i njejtë është larguar jashtë Kosovës në drejtim të panjohur.

Në fjalën përfundimtare i ka propozuar gjykatës që ta detyroj të paditurin që t'ia kthej borxhin në shumë prej 19.500.-€, pasi që kjo është vërtetuar edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor nga provat e administruara.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Në të përgjigjur në padi përfaqësuesi i përkohshëm e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit sa i përket bazës juridike ndërsa në fjalën përfundimtare i ka propozuar gjykatës që në bazë të provave të administruara dhe conformë nenit 8 të LPK-së, të vendos drejhtë në këtë çështje juridiko-civile.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar nga pala paditëse.

Për vërtetimin e gjendjes faktike në këtë çështje kontestimore gjykata bëri administrimin e provave me dëgjimin e paditësit S.J., nga D., në cilsinë e pales në procedure, dëshmitarit Nj. L. nga fsh. G. e V., dëshmitarit D. Sh. nga F., me shiqimin dhe leximin e kontratës për shitëblerjen e paluajtshmerisë Vr.nr.166/09 të dt. 27.01.2009, dhe me shiqimin dhe leximin e deklaratës të vërtetuar nr. 337 të dt. 27.01.2009, të cilat prova gjykata i administroi dhe i vlerësoi në vështrim të nenit 8 të LPK-së, ku gjeti se kërkesëpadia e precizuar e paditësit është e bazuar andaj edhe vendosi si në dispozitiv të këtijë aktgjykimi.

Nga dëgjimi i paditësit në cilsinë e pales në procedure, dëshmitarit Nj. L. dhe dëshmitarit tjetër D. Sh., në pamëdyshje u vërtetua se qysh me dt. 27.01.2009, paditësi me të paditurin kishin lidhur kontratë për shitëblerjen e paluajtshmerisë e cila kontratë është vërtetuar në Gjykatën Komunale në Lipjan, me shenjen Vr.nr. 166/09 të dt. 27.01.2009, dhe ate për paluajtshmerinë ngas. nr. 352-3, në vendin e quajtur “Shiroko pole”, dhe nga çmimi kontraktues i tërësishëm i padituri i kishte mbetur një pjesë borxh prej 19.500.-€, e të cilin çmim ka pasur obligim ta paguaj më së largu deri me dt. 01.03.2009, mirëpo këtë detyrim asnjëherë nuk e ka përmbushur. Poashtu nga dëshmitari Nj. L., i cili kishte qenë prezent disa here me palët ndërgjyqëse ka njohuri se i padituri i ka mbetur një pjesë të borxhit afër 20.000.-€, paditësit, mirëpo të njejtin ka kohë që nuk e ka par, mirëpo 2 – 3 herë është takuar në Restoranin “E.”, në L., dhe një here në Restoranin e vllaut të tijë në fsh. G.. Poashtu nga dëshmitari tjetër D. Sh. u vërtetua se një pjesë të borxhit nga shitëblerja e paluajtshmerisë që gjindet në vendin “Shiroko pole”, i padituri nuk e ka paguar dhe një here i ka thenë se duhet ta paguash këtë borxh që i ke mbetur paditësit i njejtë është përgjigjur se ti nuk ke çka të përzihesh në këtë punë dhe unë i kam borxh S., dhe ky borxh sa i kujtohet ka qenë dikun 19.000.-€, por sakt nuk e din.

Nga kontrata për shitëblerjen e paluajtshmerisë e lidhur në këtë gjykatë Vr.nr.166/09 e dt. 27.01.2009, vërtetohet se paditësi me të paditurin kanë lidhur kontratë për shitëblerjen e paluajtshmerisë dhe ate ngas. kad.nr. 00352-3, në vendin e quajtur “Shiroko pole”, në sip. prej 15165 m2, që evidentohet në ZK Suhadoll, me çmimin kontraktues prej 127.000.-€.

Nga deklarata nr. 337 e dt. 27.01.2009 e vërtetuar pranë Organit komunal, vërtetohet se i padituri E. H. ka marrë obligim që shumën e borxhit të mbetur prej 19.500.-€, ta përmbush deri me dt. 01.03.2009 në të kundërtën kontratën për shitëblerjen e paluajtshmerisë pronon që të zgjidhet.

Mbi bazën e provave të administruara gjykata vjen në përfundim se paditësi me të paditurin kanë lidhur kontratë për shitëblerjen e paluajtshmerisë të përshkruar si më lartë e të cilën kontratë e kanë vërtetuar në këtë gjykatë dhe i padituri e ka paguar pjesën më të madhe të çmimit të shitëblerjes ndërsa çmimin e mbetur prej 19.500.-€, ka marrë obligim që ta përmbush deri me dt. 01.03.2009, i cili edhe përkundër vërejtjeve këtë pjesë të borxhit nuk e ka përmbushur ndaj paditësit, ndërsa paluajtshmerinë kontestuese apo paluajtshmerinë që ka qenë object i kësaj kontrate i padituri e ka tjetërsuar në persona të tretë me përjashtim të një pjese dhe ate ngas. nr. 00352-23 në sip. prej 750 m2, ndaj të ciles gjykata me aktvendimin e dt. 03.11.2015, e ka ndryshuar masën e përkohëshme të mëparshme të sigurimit të dt. 15.11.2012, dhe për këtë pjesë të mbetur e ka ndaluar tjetërsimin apo ndryshimin e gjendjes ekzistuese deri në vendosjen në formë të prerë të kësaj çështje apo deri te nxjerrja e ndonjë vendimi tjetër lidhur me masën e përkohëshme të sigurimit.

Me dispozitat e nenit 12 të LMD-së, (Ligjit të aplikueshëm në kohën e krijimit të Marrëdhënies së Detyrimit), parashifet se “Në themelimin e marrëdhënieve të detyrimeve dhe në realizimin e të drejtave dhe detyrimeve nga këto marrëdhënie, pjesëmarrësit kanë për detyrë t’i përmbahen parimit të ndërgjegjshmerisë dhe ndershmerisë”. Gjithashtu me nenin 17 po të njejtit ligj parashifet se “Pjesëmarrësit e marrëdhënies së detyrimit kanë për detyrë ta zbatojnë detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tijë”.

Pra bazuar në gjendje e vërtetuar faktike në këtë çështje juridiko-civile dhe dispozitat e lartëcekura si dhe nenit 262 të LMD-së, (të vitit 1978), ku parashifet se kreditori në raportin e obliguar është i autorizuar që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimin ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush me ndërgjegjëje krejtësisht sikur është përmbajtja e tijë, këtu paditësi ka të drejtë të kërkoj borxhin të cilin e ka kërkuar me padi ndaj të paditurit dhe ky i fundit është përgjegjës dhe ka për detyrë ta përmbush këtë detyrim të mbetur nga kontrata për shitëblerjen e paluajtshmerisë në shumën siç është cekur në dispozitiv të këtijë aktgjykimi, andaj nga këto arsye gjykata e aprovoj kërkesëpadinë e precizuar të paditësit si të bazuar.

Me rastin e vendosjes gjykata vlerësoj pretendimet e pales së paditur respektivisht kundërshtimet e përfaqësuesit të përkohshëm rreth kontestimit të bazës juridike mirëpo të njejtin kundërshtim e refuzoj si të pabazuar nga arsyet e cekura më lartë dhe në këtë çështje vendosi mbi bazën e vërtetuar të gjendjes faktike dhe provave të cilat i administroi dhe i vlerësoi në pajtim me dispozitat ligjore e të cilave poashtu në tërësi iu fali besimin pasi që me asnjë prove deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor nuk është argumentua e kundërta nga ajo siç është vendosur në dispozitiv të këtijë aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe nenit 154 të LMD-së, u vendos si në dispozitiv të këtijë aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA LIPJAN.

C. nr. 232/12 me dt. 23.09.2016.

GJYQTARI,

Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtijë aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njejtit, përmes kësajë gjykate.